



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	06.12.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SAK	7703/2022		115



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.882/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani -Kryetar, Jeton Koca dhe Malsore Gashi Bajraktari-Anëtarë, me Rushit Kajtazi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtsitë, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.882/2022 të datës 10.10.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë kundër organit të punësimit Këshilli i Sigurisë së Kosovës, në çështjen juridike "Masë Disiplinore-Vërejtje", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 06.12.2022, mori këtë:

### V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.882/2022 e datës 10.10.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vërejtja e shqiptuar nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës e datës 06.10.2022 me numër protokolli 82/2022.

### A r s y e t i m

Ndaj ankuesit Drejtorë i Qendrës së Situatave sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Akt Emërimit të datës 05.02.2020 me nr. protokolli 40/2020, më datën 06.10.2022, Zëvendësuesi i Sekretarit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës i ka shqiptuar Masën Disiplinore "Vërejtje" për shkak të shkeljeve disiplinore për mosrespektimin e orarit të rregullt të punës siç përcaktohet me Rregulloren (QRK) Nr. 12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik.

Ankuesi i pakënaqur ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me pretendimin ankimor kundër Vërejtjes me numër 82/2022 të datës 06.10.2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 21.10.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, ndërsa Këshilli më datë 25.10.2022, me numër protokoll 6436/2022, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, me shkresat e bashkangjitura.

Për shkak të specifikave të lëndës, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 23.11.2022 ka nxjerr Vendim VK.nr.165/2022 me të cilin ka bërë zgjatjen e afatit për vendosjen e ankesës së ankuesit për dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me nr.protokoll 5992/2022 të datës 10.10.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërejtje e shqiptuar nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës e datës 06.10.2022 me numër protokoll 82/2022; E-mail nga F.I. për Sh.Sh. i datës 12.07.2022; Qendra e Situatave Raporti për prezencën në punë i Sh.Sh. i datës 12.07.2022; E-mail nga Sh.Sh. për F.I. i datës 13.07.2022; E-mail nga Sh.Sh. për V.G. etj. i datës 03.08.2022; E-mail nga V.G. për Sh.Sh. etj. i datës 31.07.2022; Qendra e Situatave Raporti për prezencën në punë i Sh.Sh. i datës 31.07.2022; Raporti mbi aktivitetet e realizuara për Sh.Sh. i datës 28.09.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër protokoll 6362/2022 e datës 21.10.2022; Përgjigje në ankesë me numër protokoll 6436/2022 e datës 25.10.2022; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i Sh.Sh. me nr.protokoll 40/2020 i datës 05.02.2020; Përshkrimi i Detyrave të Punës i datës 05.02.2020; E-mail nga F.I. për A.K. etj. i datës 13.07.2022; E-mail nga F.I. për A.K. etj. i datës 05.07.2022; E-mail nga Sh.Sh. për V.G. i datës 03.08.2022; E-mail nga Sh.Sh. për V.G. i datës 03.08.2022; Raporti për prezencën në punë i Sh.Sh. i datës 28.09.2022; E-mail nga F.I. për V.G. etj. i datës 06.10.2022; E-mail nga V.G. për Sh.Sh. i datës 04.10.2022; Procesverbal i datës 05.10.2022; Raporti për prezencën në punë i Sh.Sh. prej datës 04.07.2022 deri 24.10.2022 1/5 faqe; E-mail nga F.I. për C.Z. i datës 26.10.2022; E-mail nga V.G. për F.I. i datës 26.10.2022; E-mail nga B.P. për V.G. i datës 04.10.2022; E-mail nga F.I. për C.Z. i datës 21.11.2022; E-mail nga C.Z. për F.I. i datës 21.11.2022; E-mail nga V.G. për B.P. etj. i datës 16.09.2022; Vendim me numër VK.nr.165/2022 i datës 23.11.2022;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatoj se ankesa e parashtruar nga ankuesi është e pabazuar, **SEPSE:**

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesi sipas Ndryshim dhe Plotësimit të Akt Emërimit me nr. protokoll 40/2020 të datës 05.02.2020 është i punësuar në Këshillin e Sigurisë së Kosovës në pozitën "Drejtor i Qendrës së Situatave".

Zëvendësuesi i Sekretarit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës, si mbikëqyrës i drejtpërdrejt i ankuesit më date 06.10.2022 ka nxjerr Vendim me nr. protokoll 82/2022 me të cilin ankuesit i ka shqiptuar Masën Disiplinore "Vërejtje" me arsyetim për shkak të shkeljeve disiplinore për

mosrespektimin e orarit të rregullt të punës siç përcaktohet me Rregulloren (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik duke u bazuar se me datë 12 Korrik 2022,

ka munguar në punë pa leje dhe pa njoftim paraprak, ku ga menaxherja e Burimeve Njerëzore i është kërkuar arsyetimi për mungesën në punë. Ndërsa me datë 13 Korrik ka kthyer përgjigje për mungesën e tij në punë, duke mos u përfshirë në përgjigje të emailit mbikëqyrësin e tij të drejtëpërdrejt. Me datë 03 Gusht 2022 dërgon një email njoftues në ora 10:33h, që do të mungoj në punë. Si dhe me datë 28 Shtator ka munguar në punë, pa marrë leje paraprake nga Drejtor i Departamentit për Analiza dhe Politika të Sigurisë i cili ishte caktuar si zëvendësues në detyrë gjatë kohës sa ka qenë në udhëtim zyrtar Sekretari dhe i njëjti ka shpërfillur autoritetin e tij.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon se Vendimi për Masën Disiplinore "Vërejtje" nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës e datës 06.10.2022 me numër protokollit 82/2022 është në kundërshtim të plotë me nenin 50 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik për parimet e individualizimit të masave disiplinore si dhe në kundërshtim të plotë me nenin 13 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik "shqiptimi i masave disiplinore" dhe se eprori i drejtëpërdrejt nuk ka marrë parasysh fare rrethanat e kryerjes së shkeljes së pretenduar nuk ka bërë vlerësimin e rëndësisë së pasojave të tij, nuk ka paraqitë shkallën e fajësisë si dhe nuk ka marrë parasysh nëse kisha ndonjë masë paraprake disiplinore dhe se i njëjti nuk ka përcaktuar dëmin e shkaktuar nga shkeljet e pretenduara disiplinore.

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ankuesi me datë 12.07.2022 është evidentuar në punë në hyrje në ora 18:12, ndërsa në dalje është evidentuar në ora 19:52, ndërsa sipas dëshmimeve nga ana e institucionit më datë 03.08.2022 i njëjti nuk është evidentuar në hyrje dalje por e ka njoftuar përmes emailit në ora 09:02 me datë 03.08.2022 Sekretarin se siç të informova dje me datë 02.08.2022 se e kam nipin gjashtë (6) vjeçar të sëmurë dhe nuk mundem me ardhë në punë. Përsëri të njëjtën ditë në ora 10:33 e ka njoftuar Sekretarin si dhe Menaxheren e Personelit të SKSK se dy vajzat e tij dhe nipi i tij gjashtë (6) vjeçar kanë rezultuar me Covid-19 me arsyetimin se për shkak të temperaturës më është dashur që natën të qëndroj afër nipit si dhe mbrëmë e kam bërë testin e Covidit dhe kam dal negativ dhe sot do të mungoj në punë. Si dhe me datë 28.09.2022 është evidentuar në punë në hyrje në ora 09:17, ndërsa në dalje është evidentuar në ora 10:09.

Me datë 12.07.2022 Menaxherja e Personelit i është drejtuar me email e cila duke u bazuar në kërkesën e Sekretarit të gjitha rastet e mungesave në punë të evidentohen dhe të njëjtat do të adresohen te ju si mbikëqyrës i drejtëpërdrejt për të dhënë komentet apo arsyetimin lidhur me mungesat përkatëse. Dhe se të njëjtat do të trajtohen sipas legjislacionit në fuqi me ç'rast ka kërkuar meqë sot i njëjti nuk është në punë të dërgoj email dhe të jap arsyetimin me mosparaqitjen në punë. I njëjti me datë 13.07.2022 ka dhënë sqarime lidhur me kërkesën e menaxheres së personelit dhe të njëjtën e ka njoftuar se me datë 12.07.2022 kam pas disa obligime në administratën e Policisë në Gjilan. Me që administrata ka pasur pengesa në sistem unë nuk kam mundur që të kryej punë në kohë optimale dhe kam humbur ditën e punës. Unë jam paraqitur në vendin e punës në të njëjtën datë në ora 18:00 pas orarit të punës për të përcjellë situatën nëse kemi ndonjë obligim të pakryer. Në ndërkohë

kam marrë në telefon kam kërkuar që gjatë orarit të punës të më zëvendësoj e kam porositur që të angazhohet rreth obligimeve në QS/KSK dhe nëse paraqitet nevoja e domosdoshme unë do të lë obligimet e mia (sepse ato ishin private) dhe do të paraqitem në punë. Ndërsa me datën 28.09.2022 duke u bazuar në Raportin për prezencën në punë i njëjti ka hyrë në ora 09:17 ndërsa ka bërë dalje në ora 10:09 pa marrë leje paraprake nga eprori i tij i drejtpërdrejt i cili ishte caktuar si zëvendësues në detyrë gjatë kohës sa ka qenë në Udhëtim zyrtar Sekretari.

Lidhur me ligjshmërinë e Vendimit me Nr. protokolli 82/2022 të datës 06.10.2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës për shqiptimin e masës disiplinore "vërejtje" dhe pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave, konstaton që në bazë të raportit të prezencës në punë për periudhën 04.07.2022 deri 24.10.2022 për ankuesin, shihet që i njëjti me datë 12.07.2022 ka bërë hyrje në ora 18:12 ndërsa dalje në ora 19:52 ndërsa me datë 03.08.2022 nuk është evidentuar fare por i ka njoftuar përmes emailit si dhe me datë 28.09.2022 ka bërë hyrje në ora 09:17 ndërsa dalje në ora 10:09. Poashtu kolegji ka konstatuar se i njëjti me datë 13 Korrik ka qenë i njoftuar nga Menaxherja e Personelit lidhur me respektimin e orarit të punës, përfshirë kujdestarinë, regjistrimin në sistemin e vijueshmërisë në punë, si dhe regjistrimin në librin e pranimit dorëzimit të detyrës për zyrtarët në kujdestari.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave, lidhur me këtë çështje juridike-administrative, ju referua Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, gjegjësisht nenit 4 paragrafi 1, ku përcaktohet se: "*Orari i punës së nëpunësve civilë, stafit teknik dhe mbështetës si rregull fillon në orën 08:00 dhe përfundon në orën 16:00 pesë (5) ditë në javë duke filluar nga e hëna deri të premten*", si rrjedhojë ankuesi nuk ka ofruar asnjë provë relevante me të cilat do të vërtetonte që për këto vonesa apo mos evidentime në sistemin elektronik të hyrje/daljeve në punë të ketë njoftuar udhëheqësin e drejtpërdrejt. Përveç që gjatë orarit të punës të gjithë zyrtarët publik janë të obliguar të jenë në vendin e punës. Çdo zyrtar publik shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik siç parashihet me nenin 8 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, andaj Kolegji konstaton se për çdo largim nga vendi i punës gjatë orarit, zyrtari publik duhet të marrë leje menaxherit drejtues, siç parashihet me nenin 8 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, kështu që mos respektimi i orarit të punës paraqet shkelje disiplinore siç parashihet me paragrafin 2 të nenit 8 të Rregullores (QRK) Nr.12/2020 Për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë.

Nisur nga rrethanat si më lartë Kolegji vlerëson se mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankuesit me rastin e shqiptimit të masës disiplinore "Vërejtje" sipas Vendimit me Nr. Prot:82/2022 të datës 06.10.2022, ka konstatuar saktë përgjegjësinë disiplinore të ankuesit si dhe ka cilësuar drejtë veprimet e ankuesit si shkelje të lehtë disiplinore siç përcaktohet me nenin 46 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik si dhe nenin 48 paragrafi 2 të të njëjtit ligj më të cilin është përcaktuar se: "*Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil*", sepse zyrtari publik ka detyrimin të veprojë në përputhje me urdhrat e marrë nga mbikëqyrësit e tij, sipas

ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit siç parashihet me nenin 26 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankuesit me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ka vepruar në pajtim me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenin 48 paragrafi 1, 50 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, duke e arsyetuar vendimin në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, gjegjësisht me nenin 48 paragrafi 1 dhe të 2, andaj sa i përket pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se të gjitha pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara dhe të paqëndrueshme sepse i njëjti nuk i ka argumentuar me prova relevante.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.882/2022

Rushit Kajtazi  
  
Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Sekretarit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Këshillin e Sigurisë së Kosovës dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.